



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije
Ministry of Transport and Communications

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007, dhe nenin 230.4 të Ligjit nr. 02/L-70 Për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.

Me qëllim të përcaktimit të plan programit për aftësimin e kandidatëve për shofer dhe mënyrën e aftësimit.

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.2008/10
PLAN PROGRAMI PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet plan programi i aftësimit të kandidatëve për shofer dhe mënyra e aftësimit për kategoritë "A1", "A", "B", "C1", "C", "D1", "D", "B+E", "C1+E", "C+E", "D1+E", "D+E", "L", "M" dhe "T".

Neni 2
Aftësimi i kandidatit për shoferë

Aftësimi i kandidatit nga lëndët rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë (në tekstin e mëtutjeshëm pjesa teorike) dhe të drejtuarit e mjetit me veprim motorik (në tekstin e mëtutjeshëm pjesa praktike) realizohet në bazë të plan programit për aftësimin e kandidatëve për shofer i cili është shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Kushtet për regjistrimin e kandidatit në auto shkollë

1. Kandidati mund të regjistrohet në Auto Shkollë nëse:

- 1.1. plotëson kushtet e parapara në nenin 234.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugorë;
- 1.2. posedon certifikatën shëndetësore mbi aftësin fizike dhe psikike se është i aftë të drejtoj mjetin.

2. Auto Shkolla duhet që kandidati i cili regjistrohet për aftësimin për shofer t'i lëshoj librezën e kandidatit (në tekstin e mëtejshme librezë).

Neni 4

1. Të drejtat dhe obligimet e Auto Shkollës dhe kandidatit për aftësimin për shofer rregullohen me kontratë.

2. Kontrata duhet të përmbaj:

- 1.1. palët kontraktuese dhe objektin e kontratës;
- 1.2. obligimet e Auto Shkollës për të aftësuar kandidatin për shofer;
- 1.3. obligimet e ligjeruesit dhe shofer instruktorit për mbajtjen e orëve mësimore;
- 1.4. obligimet e kandidatit që të marrë pjesë në mësim;
- 1.5. obligimet e auto shkollës për të siguruar mjetin për provim nga pjesa praktike vetëm nëse është e nevojshme;
- 1.6. definimi i çmimit për orë mësimore për lëndët e caktuara;
- 1.7. kohëzgjatja e aftësimin;
- 1.8. mënyra e pagesës së aftësimin;
- 1.9. mënyra e ndërprerjes së kontrates;
- 1.10. mënyra e zgjedhjes së kontestit.

3. Kontraten për personin e mitur e nëshkruan përfaqësuesi ligjor, për kategorit për të cilat parashihet aftësimi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeqare.

Neni 5

1. Ministria me vendim e përcakton çmimin për një orë mësimore nga pjesa teorike dhe praktike për çdo kategori.

2. Kandidati për shoferë duhet të bëjë të gjitha pagesat në xhirrollogarin bankare të Auto Shkolles përkatëse.

Neni 6

1. Shofer instruktori i cili është i punësuar në ndonjë subjekt tjetër mund të bëjë aftësimin e kandidatit për shofer më së shumti 2 (dy) orë në ditë, respektivisht 10 (dhjetë) orë në javë.

2. Shofer instruktorit i cili e ka profesion themelor drejtimin e mjetit nuk i lejohet të bëjë aftësimin e kandidatëve për shofer.

Neni 7

Zhvillimi i mësimit

1. Mësimi nga pjesa teorike, praktike dhe dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident komunikacioni është i obligueshëm dhe realizohet në kuadër të orëve mësimore.

2. Minimumi i orëve nga pjesa teorike, praktike dhe dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident komunikacioni për kategori është përcaktuar në tabelen 1 të shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Aftësimi i kandidatëve nga pjesa teorike

1. Mësimi nga pjesa teorike organizohet në grupe. Varësisht nga hapsira e klasës mësimore grupi nuk mund të ketë më shumë se katërmbëdhjetë (14) kandidatë.

2. Ora mësimore zgjat dyzetëpesë (45) minuta. Gjatë një (1) dite kandidati për shofer mund t'i mbajë 2 (dy) ose 3 (tri) orë mësimore.

3. Në mes të orëve mësimore duhet të sigurohet pushimi prej së paku pesëmbëdhjetë (15) minuta.

4. Gjatë mbajtjes së mësimit nga pjesa teorike kandidati për shofer duhet të ketë me veti librezën.

Neni 9

Aftësimi i kandidatëve nga pjesa praktike

Mësimin nga pjesa praktike mund të fillojë kandidati për shofer i cili më parë ka përfunduar aftësimin nga pjesa teorike dhe ka kaluar me sukses testin provues në Auto Shkollë.

Neni 10

1. Pjesa praktike e aftësimit të kandidatit fillon në poligon.

2. Pas përfundimit të orëve në poligon kandidati vazhdon aftësimin në rrugë publike.

3. Gjatë mbajtjes së mësimit nga pjesa praktike kandidati për shofer duhet të ketë me veti librezën.

Neni 11

Për kategorin “A1”, “A”, “B”, “C1”, “T”, “B+E”, “C1+E”, kandidati për shofer gjatë ditës mund të mbaj vetëm një orë mësimore nga pjesa praktike, kurse pas 6 (gjashtë) orëve mësimore varësisht nga rezultatet e arritura mund t’i mbajë 2 (dy) orë gjatë dites.

Neni 12

1. Ora mësimore nga pjesa praktike për kategorin “C1” realizohet së pari në mjetin e kategorisë “B” dhe pastaj në mjetin transportues të kategorisë “C1”.

Neni 13

1. Në rrugë publike ora mësimore nga pjesa praktike për mjetet e kategorisë “A1”, “A” dhe “T”, realizohet në atë mënyrë që kandidati e drejton vetë mjetin ndërsa nga prapa e përcjell me mjet shofer instruktori.

2. Komunikimi i kandidatit dhe shofer instruktorit realizohet përmes paisjeve komunikuese.

3. Gjatë kohës së ngasjes në rrugë publike kandidati për shofer të kategorisë “A1” dhe “A” duhet të ketë të veshur jelekun me ngjyrë reflektuse të verdhë në të cilën me ngjyrë të bardhë është e shkruar shkronja “L” në katrorin e kaltër dhe helmetën mbrojtëse në kokë të atestuar.

Neni 14

Nga pjesa praktike kandidati për shofer gjatë ditës mund të mbaj më së shumti dy orë për kategoritë: “C1”, “C”, “D1”, “D”, “C1+E”, “C+E”, “D1+E” ose “D+E”. Pas përfundimit të orës mësimore shofer instruktori duhet që urdhëreses së punës t’ia bashkangjes diskfletzen e tahogرافit për secilin kandidat.

Neni 15

Shofer instruktori i cakton orët për temat – njësit mësimore kandidatit për shofer varësisht nga aftësimi i tij.

Neni 16

Riaftësimi i kandidatit për shofer

1. Kandidati i cili përsërit aftësimin duhet të rexhistrohet në “librin e evidencës së aftësimit të kandidatëve për shofer” si kandidat i ri.

2. Kandidati i cili nuk e jep provimin për shofer brenda afatit të parapar duhet të mbajë së paku 50% të orëve mësimore për kategorinë përkatëse.

Neni 17

Dokumentacioni dhe Evidenca

1. Auto Shkolla për aftësimin kandidatëve duhet të mbaj:

- 1.1. Librin e evidences së aftësimit të kandidatëve për shofer;
- 1.2. Ditarin për mbajtjen e orëve mësimore nga pjesa teorike dhe
- 1.3. Dosjen e kandidatit.

2. Dosja e kandidatit përmban:

- 2.1. Kontraten për aftësimin e kandidatit;
- 2.2. Urdhëresen e punës së shofer instruktorit;
- 2.3. Librezen e kandidatit për shofer;
- 2.4. Diskfletëzen e tahografit për kategoritë “C1”, “C”, “D1”, “D”, “C1+E”, “C+E”, “D1+E” dhe “D+E” ;
- 2.5. Vërtetimin për përfundimin e aftësimit të kandidatit.

3. Libri duhet të ruhet vazhdimisht ndërsa ditari dhe dosja e kandidatit 5 (pesë) vite nga data e mbarimit të aftësimit të kandidatit për shofer.

4. Udhëheqësi i Auto Shkollës ose personi tjetër i autorizuar duhet që “librin e evidences së aftësimit të kandidatëve” ta mbyll në ditën e fundit të çdo muaji dhe në te të shkruan:

“mbyllet me numrin rendor nr.____, nënshkrimin dhe vulën.

5. Auto shkolla obligohet që në fund të çdo muaji të dorëzon në Ministri listën e kandidatëve të regjistruar për muajin paraprak.

Neni 18

Format standarde të dokumentacionit nga paragrafi 1 pika 1.1. dhe 1.2. dhe paragrafi 2 pika 2.1, 2.2, 2.3, dhe 2.5 të këtij Udhëzimi Administrativ i përcakton Ministria, i publikon në web faqe i njofton dhe ua dërgon në formë elektronike Auto Shkollave.

Neni 19

Dispozitat kalimtare

1. Kandidati i cili ka filluar aftësimin para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ duhet që brenda 3 (tre) muajve të përfundojn aftësimin sipas rregullave të Udhëzimit Administrativ 2004/9.

2. Në qoftë se kandidati nuk e përfundon aftësimin në afatin e paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, Auto Shkolla është e obliguar të aftësoj sipas rregullave të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Neni 3 paragrafi 2 i këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohet nga data 1 janar 2009.

Neni 20 **Dispozita shfuqizuese**

Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohen Udhëzimi Administrativ nr. 2004/9 plan programi për aftësimin e kandidatëve për shofer dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2006/2 Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ 2004/9 plan programi për aftësimin e kandidatëve për shofer.

Neni 21 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Fatmir Limaj,

Ministër i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit.

Datë _____

SHTOJCA. I

PLAN PROGRAMI I AFTËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR SHOFER

Minimumi i orëve nga pjesa teorike dhe praktike si dhe dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident komunikacionit për kategorit e caktuar është paraqitur në tabelen vijuse:

Tabela 1

Kategoria	Lëndët	Orët	Posedon kategoritë														
			A1	A	B	B+E	C1	C1+E	C	C+E	D1	D1+E	D	D+E	L	M	T
A1	RRKS	16													4	4	4
	DMM	10			10	10	10	10	10	10	10	10			10	10	10
	NP	9															
A	RRKS	16													4	4	4
	DMM	10			10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10
	NP	9															
B	RRKS	16	4	4											4	4	4
	DMM	16	10	10											10	10	10
	NP	9															
B+E	RRKS				5												
	DMM				10												
	NP																
C1	RRKS	26	10	10	10	10									10	10	10
	DMM	16+ *10	10+ *10	10+ 10	10	10									16+ *10	16+* 10	16+ *10
	NP	9															
C1+E	RRKS					5											
	DMM					10											
	NP																
C	RRKS				10	10	5	5									
	DMM				15	15	15	15									
	NP																
C+E	RRKS																
	DMM								10								
	NP																
D1	RRKS								10	10							
	DMM								15	15							
	NP																
D1+E	RRKS																
	DMM										15	15					
	NP																
D	RRKS								10	10	5	5					
	DMM								15	15	10	10					
	NP																
D+E	RRKS													15			
	DMM																
	NP																
L	RRKS	16														4	4
	DMM																
	NP	9															
M	RRKS	16													4		4

	DMM																
	NP	9															
T	RRKS	10												4	4		
	DMM	10												10	10		
	NP	9															

RRKS- rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë

DMM-të drejtuarit e mjetit motorik

NP- dhënia e ndihmes së parë personave të lënduar në aksident komunikacioni

*Mjeti i transportit të kategorisë C1

A - PJESA TEORIKE

PROGRAMI BAZË I AFTËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR SHOFER NGA LËNDA MËSIMORE RREGULLAT E KOMUNIKACIONIT DHE TË SIGURISË

Nr.	Kapitujt mësimor	Temat / njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Rregullat e komunikacionit		
1.1.	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor; Nocionet bazë; Kushtet për drejtimin e mjeteve; Kategoritë e mjeteve me veprim motorik; Aftësimi i kandidatëve për shofer; Mënyra e dhënjes së provimit për shofer; Fitimi i të drejtës për ta drejtuar mjetin; Marrja dhe revokimi i patent shoferit; Detyrat dhe përgjegjësit e pjesëmarrësve në komunikacion.	1
2	Shenjat e komunikacionit		
2.1	Shenjat e komunikacionit	Vendosja, forma, ngjyra dhe simboli; Llojet e shenjave të komunikacionit; Shenjat të cilat i jep personi i autorizuar; Përceptimi i shenjave të komunikacionit; Të vepruarit sipas shenjave të komunikacionit; Shenjat paralajmruese ,akustike dhe ndriçuese; Shënjëzimi dhe sinjalizimi; Shenjat tjera	1
3.	Rregullat themelore të komunikacionit rrugor		

3.1	Shoferi	<p>Shiqimi nga mjeti; Këndi dhe fusha e të pamurit; Ngasja e kujdesshme; Raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë në komunikacionin rrugor; Vlerësimi dhe vendimmarrja; Koha e reagimit; Përceptimi; Gjykimi; Ndryshimet në sjelljet e ngasjes si shkak i ndikimit të alkoolit, medikamenteve narkotike Gjendja psikike dhe fizike; Lodhja.</p>	1
3.2	Mjeti:	<p>Forcat natyrore-energji e lëvizjes; Forcat të cilat ndikojnë në mjet; Masat e nevojshme të sigurisë gjatë hyrjes dhe daljes nga mjeti; Mjeti si faktorë i sigurisë në komunikacionin rrugor; Motori me pajisje; Sistemi për drejtim; Sistemi për frenim; Sistemi i mbështetës; Pneumatikët; Pajisjet ndriçuese dhe sinjalizuese, reflektorët, pasqyret e brendshme dhe anësore; Xhami ballor dhe fshisat; Sistemi i shkarkimit të gazrave të motorit; Sinjalet akustike dhe paralajmruese; Ngasja ekonomike; Katalizatorët (ngasja ekologjike); Rripat e sigurisë, mbështetëset e kokës dhe pajisja për siguri të fëmijës; Regjistrimi dhe kontrolla teknike; Sigurimi i mjetit; Tërheqja e mjetit; Sjellja në rast të prishjes së mjetit; Përgatitja për ngasje</p>	2
3.4	Rruga	<p>Rruga e ndaljes së mjetit; Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes; Kushtet për kryerjen e manovrimeve të sigurta me mjet në komunikacion; Mbajtja nën kontroll e mjetit ; Faktorët e ndryshëm të rrezikut në rrugë; Karakteristikat e rrugëve; Rruga dhe shënjzmi; Punimet në rrugë.</p>	1
3.5	Pjesëmarrësit më të rrezikuar në komunikacion	<p>Fëmijët; Këmbësorët; Personat me aftësi të kufizuara; Biçiklisti, çiklomotoristi dhe motoçiklisti .</p>	1

3.6	Rregullat tjera	Dokumentacioni i mjetit për përdorim në komunikacion; Faktorët e sigurisë në lidhje me mjetin, ngarkesën dhe bartjen e personave.	1
3.7	Sjellja e pjesëmarrësve në komunikacion	Qëndrimet pozitive në komunikacion; Raporti ndërmjet pjesëmarrësve në komunikacion; Komunikacioni dhe ambienti- ekologjia; Ngasja ekonomike; Si duhet të sillemi në komunikacion; Reagimi, shpejtësia, saktësia dhe efikasiteti; Ngasja defanzive (mbrojtëse) në komunikacion; Ndryshimet në sjelljet e shoferit si shkak i ndikimit të alkoolit dhe medikamenteve narkotike; Gjendja fizike dhe psikike; Lodhja; Sjellja e shoferit si shkak i aksidentit në komunikacion.	1

4.	Ngasja në vendbanim		
4.1	Ngasja në vendbanim	Karakteristikat bazë të komunikacionit në vendbanim; Shpejtësia e ngasjes; Drejtimi i komunikacionit në kryqëzime; Ngasja në rrugë me komunikacion në një kahje; Komunikacioni në rreth rotullim; Shiriti rezervë për mjetet e transportit publik dhe të komunikacionit me ndërrim të kahjes së lëvizjes; Transporti publik i udhëtarëve-urban; Kycja dhe çkycja në komunikacion; Ngasja në kryqëzim në shumë nivele; Rreshtimi i mjeteve; Zgjedhja e shiritit të komunikacionit dhe kthimi; Ngasja në kolonë; Ngasja në vendkalim hekurudhorë; Ngasja në vale të gjelbërta /semafor/; Ndalja dhe parkimi; Kthimi gjysëm rrethor dhe lëvizja mbrapa; Lëvizja e këmbësorëve; Komunikacioni i biçikletave dhe çikolmotorëve	2
5.	Ngasja jashtë vendbanimit		
5.1	Ngasja jashtë vendbanimit	Karakteristikat bazë të komunikacionit jashtë vendbanimit; Përcaktimi i shpejtësisë së ngasjes; Përshtatja e shpejtësisë së ngasjes; Kycja dhe çkycja në komunikacion; Ngasja në kolonë dhe distancë ndërmjet mjeteve; Ngasja në vendkalim hekurudhorë; Komunikacioni në tunel; Tejkalimi, anashkalimi dhe përballkalimi; Ndalja ,kthimi gjysëm rrethor dhe lëvizja mbrapa; Ngasja në pjerrtësi gjatësore;	2

		Ngasja nëpër kthesa, në autoudhë dhe në rrugë të rezervuara për komunikacion të mjeteve motorike; Lëvizja e këmbësorëve	
6.	Ngasja në kushtet e veçanta		
6.1	Ngasja në kushtet e veçanta	Pashmëria e zvogëluar/kufizuar/ Ngasja natën; Përdorimi i dritave në komunikacion; Ngasja në kushte të vështira atmosferike; Lodhja.	1
7.	Sjellja në rast aksidenti të komunikacionit	Aksidenti i komunikacionit; Sjellja në rast aksidenti të komunikacionit.	1
8.	Mbikqyrja e komunikacionit dhe denimet	Mbikqyrja dhe drejtimi i komunikacionit; Mbikqyrja e mjetit dhe shoferit; Gabimet në komunikacion dhe dënimet.	1
Gjithsejt			16

I. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “A1”dhe “A”

Kandidatët të cilët nuk e kanë të dhënë provimin për shoferë për asnjë kategori, aftësimi realizohet sipas programit bazë dhe plotësohet me kapitujtë mësimor me nr. 1 dhe 2. sipas përmbajtjes së dhënë në tabelën vijuese.

Kandidati i cili posedon cilëndo kategori të mjeteve me veprim motorik, i nënshtrohet aftësimin vetëm nga pika 1.dhe 2. sipas përmbajtjes së dhënë në tabelën vijuese

Nr.	Kapitujt mësimor	Temat / njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Rregullat e komunikacionit	Karakteristikat e ngasjes me motoçikletë; Rreziqet gjatë ngasjes me motoçikletë; Stabiliteti i motoçikletës; Forcat të cilat ndikojnë në motoçikletë; Rruga e ndaljes së motoçikletës; Rregullat të cilat kanë të bëjnë me ngasjen e motoçikletës.	2
2.	Motoçikleta në funksion të sigurisë në komunikacion	Motoçikleta në funksion të sigurisë në komunikacion; Paisjet për ngasësit e motoçikletës; Frenimi dhe ndalja e motoçikletës; Bashkëudhëtari në motoçikletë; Transportimi i bagazhit.	2
Gjithsejt			4 o/m

II. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “B”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatve për shofer të mjeteve të kategoris “B” , realizohet sipas përmbatjes së plan-programit mësimor bazë.

III. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “B+E”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatve për shofer të mjeteve të kategoris “B+E” , realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelën vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimor	Temat / njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor	Nocionet bazë të cilat kanë të bëjnë me mjetet bashkangjitime; Kushtet për drejtimin e mjeteve bashkangjitime; Mënyra e dhënies së provimit për shofer; Fitimi i të drejtës për të drejtuar mjetet bashkangjitime.	1
2.	Rregullat e komunikacionit rrugor	Rruga e ndaljes së mjeteve bashkangjitime; Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes; Kushtet për kryerjen e manovrimeve të sigurta me mjet në komunikacion.	1
3.	Mjeti në funksion të sigurisë së komunikacionit rrugor	Llojet e mjeteve tërheqëse dhe bashkangjitime; Dimenzionet, masat dhe ngarkesa boshtore e rimorkios; Konstruktimi i rimorkios; Paisjet për kyçje dhe çkyçje të mjetit bashkangjites; Pajisjet e mjeteve bashkangjitime; Pajisjet ndriçuese, sinjalizuese të mjeteve bashkangjitime; Frenat dhe frenimi i mjeteve bashkangjitime; Shënjëzimi i mjeteve bashkangjitime.	3
Gjithsejt			5 o/m

IV. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “C1” dhe ”C”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatëve për shofer të mjeteve të kategoris ”C1” dhe ”C” , realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelen vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Rregullat e komunikacionit rrugor	Forcat te cilat ndikojnë në mjet; Rruga e ndaljes së mjetit; Distanca ndërmjet mjeteve në levizje; Kushtet për ngasje të sigurtë në komunikacion ; Ngasja, kandi i vdekur, rreshtimi dhe kthimi; Shpejtësia e ngasjes.	2

2.	Mjeti si faktor i sigurisë në komunikacion rrugor	Lloji i mjeteve transportuse; Dimenzionet ,masa dhe ngarkesa boshtore; Konstrukcioni i mjetit; Shikushmëria ; Njohja e punës dhe mirëmbatja e mekanizmave të cilat mundsojnë ngasje të sigurtë; Tabela instrumentale; Paisjet sinjalizuese; Motori; Mekanizmi transmetues; Sistemi i drejtimit; Sistemi i frenimit; Pneumatikët; Terheqja e mjetit; Shënjëzimi i mjetit transportues; Pregatitja për ngasje.	4
3.	Transport i ngarkesës	Kohëzgjatja e të drejturit të mjetit transportues; Transporti i ngarkesës; Kushtet të cilat duhet ti plotësojë mjeti; Obligimet e shoferit; Stabiliteti i mjetit; Vendosja dhe përforcimi i ngarkesës; Transporti i ngarkesës speciale; Transporti jashtë linjor; Transporti i kafsheve; Shënjëzimi i ngarkesës në mjet; Transporti materieve ,masa e siguruar dhe paisjet e mjetit; Obligimet e shoferit dhe ekuipazhit; Dokumentacioni përkatës	4
Gjithsejt			10 o/m

V. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “C1+E” dhe “C+E”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatve për shofer të mjeteve të kategorisë “C1 +E” dhe “C+E”, realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelën vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Rregullat e komunikacionit	Nocionet bazë të cilat kanë të bëjnë me mjetet bashkangjitime; Kushtet për drejtimin e mjeteve bashkangjitime; Mënyra e dhënies së provimit për patent shofer ; Fitimi i së drejtës për drejtimin e mjetit bashkangjites.	1
2.	Mjeti si faktor i sigurisë në komunikacion	Rruga e ndaljes së mjeteve bashkangjitime; Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes; Kushtet për kryerjen e sigurt të veprimeve me mjetin bashkangjites –këndi i vdekur; Shpejtësia e ngasjes.	1

3.	Transport i ngarkesës	Lloji i mjeteve tërheqëse dhe bashkangjitime ; Dimensionet, masa dhe ngarkesa boshtore e rimorkios; Konstrukcioni i rimorkios dhe gjysëm rimorkios; Konstrukcioni i pajisjeve bashkangjitime; Pajisjet e mjeteve bashkangjitime; Pajisjet ndriqese-sinjalizuese të mjetit bashkangjites; Frenat dhe frenimi i mjetit bashkangjites; Pneumatikët; Transporti i ngarkesës dhe personave; Vendosja dhe përforcimi i ngarkesës; Shënjëzimi i ngarkesës në mjet; Transporti i materijve të rrezikshme dhe masat e siguris; Shënjëzimi i mjetit bashkangjites; Përgatitja për ngasje.	3
Gjithsejt			5 o/m

VI. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË "D1" dhe "D"

Programi mësimor për aftësimin e kandidatëve për shofer të mjeteve të kategoris "D1" dhe "D", realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelen vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Nocionet bazë dhe përgjegjësit e pjesmarrësve në komunikacion	Nocionet bazë; Kushtet për drejtimin e mjetit ; Mënyra e dhënies së provimit për shofer; Fitimi i të drejtës për të drejtuar mjetin.	1
2.	Forcat të cilat ndikojn në mjet dhe rregullat e komunikacionit	Rruga e ndaljes së mjetit; Distanca ndërmjet mjeteve në lëvizje ; Kushtet për ngasje të sigurtë në komunikacion ; Ngasja, këndi i vdekur, rreshtimi dhe kthimi; Shpejtësia e ngasjes.	1
3.	Autobusi si faktor i siguris në komunikacion	Llojet e autobusëve; Dimenzionet ,masa dhe ngarkesa boshtore; Konstrukcioni i autobusit; Shiqushmëria prej autobusit; Njohja e punës dhe mirëmbatja e mekanizmave të cilat mundësojnë ngasje të sigurt; Tabela instrumentale; Pajisjet sinjalizuese; Motori; Mekanizmi transmetues; Sistemi i drejtimit; Sistemi i frenimit; Pneumatikët; Tërheqja e mjetit; Transporti i personave; Transporti i bagazhit dhe ngarkesës;	4

		Përgatitja për ngasje; Sjellja në rast defekti në autobus.	
4.	Transporti i udhëtarëve	Kohëzgjatja e drejtimit me autobus; Llojet e transportit; Rendi i udhëtimit; Sjellja e shoferit në vendndalim të autobusave; Kycja dhe çkycja nga vendndalimi i autobusave; Transporti i fëmijve shkollor; Shënjëzimi i autobusit; Transporti urban ; Transporti ndërurban; Transporti turistik; Transporti për nevoja personale; Sjellja në stacion të autobusave; Obligimet e shoferit dhe ekupazhit; Dokumentacioni përkatës.	4
Gjithsejt			10 o/m

VII. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “D1+E” dhe “D+E”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatve për shofer të mjeteve të kategoris “D1+E” dhe “D+E”, realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelen vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Forcat të cilat ndikojn në mjet dhe rregullat e komunikacionit	Rruga e ndaljes së mjeteve bashkëngjitëse; Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes; Kushtet për kryerjen e sigurt të veprimeve me mjetin bashkëngjitës –këndi i vdekur; Shpejtësia e ngasjes.	1
2.	Mjeti si faktor i siguris në komunikacion	Lloji i mjeteve tërheqëse dhe bashkëngjitëse; Dimensionet masa dhe ngarkesa boshtore e rimorkios; Konstrukcioni i autobusit; Konstrukcioni i pajisjeve bashkëngjitëse; Pajisjet ; Pajisjet sinjalizuese ; Frenat dhe frenimi; Frenimi i rimorkios; Pneumatikët; Tërheqja e mjetit; Transporti i personave; Transporti i bagazhit dhe ngarkëses; Vendosja dhe përforcimi i ngarkëses; Shënjëzimi i ngarkësës në mjetin bashkëngjitës; Pajisjet e mjetit bashkëngjitës; Dokumentacioni përkatës; Përgatitja për ngasje; Veprimi në rast defektit në mjetin bashkëngjitës.	4

Gjithsejt	5 o/m
------------------	--------------

VIII . PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “L”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatëve për shofer të mjeteve të kategoris “L” realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelen vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimor	Temat / njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor; Nocionet bazë; Kushtet për drejtimin e mjeteve; Detyrat dhe përgjegjësit e pjesëmarrësve në komunikacion;	1
2.	Shenjat e komunikacionit	Vendosja,forma,ngjyra dhe simboli; Llojet e shenjave të komunikacionit; Shenjat të cilat i jep personi i autorizuar; Përceptimi i shenjave të komunikacionit; Të vepruarit sipas shenjave të komunikacionit; Shenjat paralajmruese, akustike dhe ndriçuese.	2
3.	Rregullat themelore		
3.1	Shoferi	Ngasja e kujdesshme; Raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë në komunikacionin rrugor; Vlerësimi dhe vendimmarrja ; Përceptimi; Ndryshimet në sjelljet e ngasjes si shkak i ndikimit të alkoolit, dhe medikamenteve narkotike; Gjendja psikike dhe fizike; Lodhja.	1
3.2	Mjeti	Forcat natyrore-energjia e lëvizjes; Forcat të cilat ndikojnë në mjet; Sistemi për drejtim; Sistemi për frenim; Pneumatikët; Pajisjet ndriçuese dhe sinjalizuese,reflektorët, pasqyret e mbrendshme dhe anësore; Sinjalet akustike dhe paralajmëruese; Ngasja ekonomike; Regjistrimi dhe kontrolla teknike; Sigurimi i mjetit; Tërheqja e mjetit; Veprimi në rast te prishjes së mjetit.	2
3.3	Rruga	Rruga e ndaljes së mjetit; Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes; Kushtet për kryerjen e manovrimeve të sigurta me mjet në komunikacion; Mbajtjen nën kontroll të mjetit ; Punimet në rrugë.	1

4	Ngasja	Shpejtësia e ngasjes; Drejtimi i komunikacionit në kryqëzim; Ngasja në rrugë në komunikacion në një kahje; Komunikacioni me rreth rrotullues; Kuçja dhe çkyçja në komunikacion; Ngasja në kryqëzime me shumë nivele; Rreshtimi i mjeteve; Zgjedhja e shiritit të komunikacionit dhe kthimi; Ngasja në kolonë; Lëvizja e këmbësorëve.	1
5	Ngasja në kushtet e veçanta	Pashmëria e zvogluar/kufizuar/ Ngasja natën; Përdorimi i dritave në komunikacion; Ngasja n; kushte t; v;shtira atmosferike; Lodhja .	1
6	Veprimi në rast aksidenti të komunikacionit	Aksidenti i komunikacionit; Veprimi në rast aksidenti të komunikacionit.	1
Gjithsejt			10 o/m

IX. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “M”

Kandidat të cilët nuk kanë të dhënë provimin për shofer për asnjë kategori të mjeteve, aftësimi realizohet sipas përmbatjes të programit mësimor bazë. Kapitujt mësimor me numrin rendor 1 dhe 2 për kandidat për shofer të kategorisë “M”, realizohet sipas përmbatjes për kategorin “A”.

X. PROGRAMI MËSIMOR PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER TË MJETEVE TË KATEGORISË “T”

Programi mësimor për aftësimin e kandidatëve për shofer të mjetit për kategorin “T” realizohet sipas përmbatjes së dhënë në tabelen vijuese:

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve
1.	Dispozitat për sigurinë në komunikacionin rrugor	Nocionet bazë; Kushtet për drejtimin e traktorit ; Mënyra e dhënies së provimit për shofer; Fitimi i të drejtës për të drejtuar mjetin.	2
2.	Rruga	Forcat të cilat ndikojn në traktor; Rruga e ndaljes së traktorit ; Ngasja, këndi i vdekur,rreshtimi dhe kthimi; Rregullat të cilat aplikohen në ngasjen e traktorit; Shpejtësia e ngasjes.	3
3.	Traktori si faktor i siguris në komunikacion	Lloji i traktorve, mjetet bashkangjitime dhe veglat punuese; Paisjet e traktorit; Konstrukcioni i traktorit (me ose pa kabin); Shiqushmëria prej traktorit;	5

	<p>Paisjet bashkangjitëse për lidhjen e traktorit me mjetin bashkangjitës dhe veglat punuese; Stabiliteti i traktorit me mjetin bashkangjitës dhe veglat Pashmëria prej traktorit; Paisjet shtesë(kompresori etj); Tërheqja e mjetit bashkangjitës (rimorkio, qerrja); Tërheqja dhe bartja e veglave punuese; Kycja në rrugë me sipërfaqe të shtruar me asfalt ; Transporti i ngarkesës dhe personave; Transporti i kafshëve shtëpiake; Mirëmbatja e traktorit; Përgatitja për ngasje.</p>	
Gjithsejt		10 o/m

B - PJESA PRAKTIKE**PROGRAMI BAZË PËR AFTËSIMIN E KANDIDATËVE PËR SHOFER NGA LËNDA MËSIMORE TË DREJTUARIT E MJETIT ME VEPRIM MOTORIK**

Nr.	Kapitujt mësimorë	Fondi i oreve	Tema mesimore
1	Aftësimi fillestar në poligon		1.1 -
2	Aftësimi në vendbanim		2.1 -
3	Aftësimi jashtë vendbanimit		3.1 -
4	Aftësimi në kushtet e veçanta (pashmëri e zvogëluar-natën)		4.1 -
5	Ngasja testuese para provimit		5.1-
	Gjithsejt	16 o/m	

Nr.	Kapitujt mësimorë	Temat/njësitë mësimore	Fondi i orëve	Temat mësimore
1.	AFTËSIMI FILLESTAR NË POLIGON			
